



A.nr.2074/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2074/2025, të datës 26.12.2025, të parashtruar nga ankuesja L.H, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.2074/2025, e datës 26.12.2025, e parashtruar nga ankuesja L.H.

II. Anulohet Vendimi me numër protokollit 5380/02, i datës 27.12.2025, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa, **shfuqizohen** Vendimi me numër protokollit I-806/01, i datës 13.08.2025, Vendimi me numër protokollit I-1249/01 i datës 19.11.2025, Vendimi me numër protokollit I-609/01, i datës 04.07.2025, si dhe Vendimi me numër protokollit I-1252/01 i datës 19.11.2025, të Zëvendësministrit në detyrë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

III. Obligohet Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që në zbatim të këtij vendimi caktimin e Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhe caktimin e Ushtruesit të Detyrës së Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut në kuadër të kësaj ministrie, ta bëjë në pajtim të plotë me ligjin material dhe pikëpamjet si në arsyetimi të këtij vendimi, e të gjitha këto brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Obligohet Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesen ta kthejë në vendin saj të punës sipas Ndryshim dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 20.01.2013, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja, L.H (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), më datë 26.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 5380/02, të datës 27.12.2025, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes të cilit akt i është shqiptuar masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, me datë 31.12.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 13.01.2026 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryesuesi i Këshillit pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, përmes Vendimit me numër VK/2026 dhe numër protokolli 606/2026 të datës 04.02.2026, ka shtyrë afatin për vendorsje të ankesës me numër A.nr.2074/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)
administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 8079/2025 të datës 26.12.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Vendimin me numër protokolli 5380/02 të datës 27.11.2025; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me numër protokolli I-1142/19 të datë 23.10.2025; Komunikimin elektronik të datës 01.09.2025; Komunikimin elektronik të datës 16.09.2025; Komunikimin elektronik të datës 26.09.2025; Fotografime nga platforma e ARBK-së; Plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore me numër protokolli I-1254/19 të datës 19.11.2025; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 11.12.2025; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 25.08.2025; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 12.08.2025; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 14.11.2025; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 27.11.2025; Raportin nga konsulta të datës 15.09.2025; Raportin nga konsulta të datës 01.09.2025; Raportin nga konsulta të datës 20.11.2025; Udhëzimin për konsultim të datës 05.08.2025; Udhëzimin për konsultim të datës 20.11.2025; Recetën për barna të datës 17.11.2025; Recetën për barna të datës 31.07.2025; Raportin nga konsulta të datës 10.12.2025; Raportin e vizitës mjekësore të datës 17.11.2025; Raportin specialistik të datës 26.11.2025; Raportin e vizitës mjekësore të datës 18.11.2025; Komunikimet elektronike të datës 31.07.2025; Komunikimin elektronik të datës 15.09.2025; Kopje e letërnjoftimit të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 13.01.2026; Procesverbalin e datës 02.12.2025; Akt emërimit të datës 30.01.2012, me përshkrimin e detyrave të punës; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 19.11.2013, me përshkrimin e detyrave të punës të datës 12.11.2014; Akt emërimit të datës 01.08.2025; Raport i vijueshmërisë nga data 31.07.2025 deri më 20.11.2025; Vendimin me numër protokolli 9533-01 të datës 26.11.2021, me përshkrimin e detyrave të punës të datës 10.05.2017; Vendimin

me numër protokolli 36581 të datës 21.06.2023, me përshkrimin e detyrave të punës të datës 10.05.2017; Raporte e pushimeve të ankueses nga data 27.11.2017 deri më 31.07.2025; Akt emërimit AE.Nr.38/2024 të datës 26.02.2024, me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me numër protokolli I-1252/01 të datës 19.11.2025; Vendimin me numër protokolli I-609/01 të datës 04.07.2025; Vendimin me numër protokolli I-1071/01 të datës 10.10.2024; Komunikimin elektronik të datës 24.10.2025; Komunikimin elektronik të datës 21.11.2025; Komunikimin elektronik të datës 01.12.2025; Vendimin me numër protokolli I-780/02 të datës 04.08.2025; Vendimin me numër protokolli I-1212/02 të datës 10.11.2025; Akt emërimit me Nr.1/2024 të datës 15.08.2024; Akt emërimit AE.Nr.35/2024 të datës 26.02.2024; Akt emërimit me Nr.1 të datës 28.10.2024, me përshkrimin e detyrave të punës; Fotografime nga platforma SIMBNJ; Procesverbalin e datës 25.11.2025; Listat e pagave të ankueses; Komunikimin elektronik të datës 29.07.2025; Vendimin me Nr.02 Ref.344 të datës 11.11.2024; Vendimin me numër protokolli 229/26 të datës 19.02.2026, të APK-së; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datë 02.12.2019; Vendimin Ref.01/Nr.62 të datës 13.08.2025; Vendimin Ref.01/Nr.87 të datës 19.11.2025; Diplomën me Nr.279 të datës 19.11.2013; Diplomën me Nr.99/23 të datës 07.10.2023; Diplomën me Nr.1771 të datës 08.01.2013; Raportin e vijueshmërisë nga data 01.01.2025 deri më 27.11.2025; Vendimin me numër protokolli 1481/15 të datës 12.08.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankueses konstatoi se ankesa **është e bazuar**, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja është nëpunësve civile e punësuar pranë Ministrisë së Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, përkatësisht:

- sipas Akt emërimit të datës 30.01.2012, rezulton se ankuesja ka mbajtur pozitën e *Zyrtares për Procedura Administrative në Zyrën e Inspektoratit*;
- sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 19.11.2013, është emëruar në pozitën e punës *Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Juridike në Inspektoratin e Tregut*;
- me Vendimin me numër protokolli 9533-01 të datës 26.11.2021, të Ministres, ankuesja është caktuar *zëvendësuese e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut*; si dhe,
- me Vendimin me numër protokolli 3658-1 të datës 21.06.2023, të Ministres, ankuesja është emëruar *zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë*.

Tutje, Ushtruesja e Detyrës së Kryeinspektore në Inspektoratin e Tregut, përmes shkresës me numër protokolli I-1142/19 të datës 23.10.2025, drejtuar Komisionit Disiplinor të organit përkatës të punësimit, në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, me pretendime për shkelje të disiplinore të parapara me nenin 55, nenin 56 paragrafi 4, nën paragrafët 4.5, 4.7, 4.8 dhe 4.10 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 4, nenin 5, paragrafin 3, nën paragrafët 3.3, 3.7, 3.8 dhe 3.10 të Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, si dhe nenin 10 paragrafin 3, nenin 11 paragrafin 2 dhe nenin 15, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik.

Ndërsa, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, përmes Vendimit me numër protokolli 5380/02, të datës 27.12.2025, për shkak të shkeljes së detyrave dhe përgjegjësisë sipas

nenit 55, 56 paragrafi 4, nën paragrafëve 4.5, 4.8 dhe 4.10, nenit 61 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ka shqiptuar ankueses masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Vendimit me numër protokolli 5380/02, të datës 27.12.2025, të Komisionit Disiplinor të organit punëdhënës, pretendon se pushimin vjetor e mjekësor, i ka realizuar në respektim të dispozitave ligjore, ngase për këtë çështje fillimisht thekson se ka njoftuar zv. Ministrin, ndërsa më tej Divizionin e Burimeve Njerëzore. Ndër të tjera ankuesja, thekson se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, sa ishte në pushim nuk ka pranuar asnjë Vendim zyrtar që të konstatoj shfuqizimin/pezullimin e caktimit të saj si zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, apo përcaktimin se nëse është caktuar një zyrtar tjetër në këtë pozitë, apo sqarimin e sistemit të saj institucional, përkatësisht pozitën e radhës ku do ta ushtronte ankuesja pas ndryshimeve ligjore, dhe në mungesë të kësaj ankuesja pretendon se i janë krijuar paqartësi nga organi i punësimit se kujt duhej ti raportonte apo të paraqitej pas përfundimit të pushimit. Gjithashtu, në ankesën e parashtruar, ankuesja konteston ligjshmërinë e vendimit mbi caktimin në pozitën përkatëse të iniciueses së kësaj procedure disiplinore si dhe po ashtu të zyrtarit i cili ka themeluar organin që ka nxjerrë aktin e kundërshtuar me ankesë. Rrjedhimisht, pretendon se procedura disiplinore ndaj saj është ndërtuar mbi paqartësi institucionale, mungesë kompetence, vlerësim të gabuar të fakteve dhe shkeljeve të rënda të ligjit material, ndaj, ankuesja kërkon aprovimin e ankesës, anulimin e aktit kontestues me konstatimin e pavlefshmërisë së kësaj procedure disiplinore të iniciuar nga organi pa kompetencë, si dhe shfuqizimin e vendimit për caktimin e znj. E.K, Ushtruese të Detyrës së Kryeinspektore në Inspektoratin e Tregut.

Këshilli, përgjatë periudhës kohore të shqyrtimit të kësaj ankese, përkatësisht me datë 29.02.2026, në postën elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka pranuar nga ankuesja Vendimin me numër protokolli 229/26 të datës 19.02.2026, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, përmes së cilit vendim kjo e fundit ka mbyllur rastin me numër DPKI-OZQOMY-0266, për znj. L.H, Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Juridike dhe Administrative në Inspektoratin e Tregut-Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, pasi që nuk është konstatuar papajtueshmëri, përkatësisht konflikt i interesit në ushtrimin e funksionit publik sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili është publikuar me datë 02.06.2025, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe ka hyrë në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 19 të këtij ligji, përkatësisht me datë 17.06.2025, i cili ndër të tjera me nenin 18 paragrafin 1, ka paraparë se: *1. Vendimet për caktimin e zyrtarëve si zëvendësues në pozita të lira drejtuese bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura konsiderohen të shfuqizuara tridhjetë (30) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Obligohen institucionet që brenda këtij afati të përshtatin këto vendime në përputhje me nenin 35 të ligjit bazik*, ka analizuar fillimisht Vendimin me numër protokolli 3658-1 të datës 21.06.2023, të Ministres së Ministrisë së Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, me të cilin akt ankuesja në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura është emëruar zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, dhe konstaton se i njëjti akt me anë të kësaj baze ligjore me automatizëm apo në mënyrë të heshtur është shfuqizuar me datë 16.07.2025, nga rrjedhë se ankuesja nga

kjo datë e tutje është dashur të vazhdojë ushtrimin e pozitës sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 19.11.2013, ndërsa, DBNJ e organit përkatës të punësimit, lidhur me këtë çështje rezulton se nëpunësit e kësaj ministrie, duke përfshirë këtu edhe ankuesen i ka njoftuar përmes postës elektronike vetëm me datë 29.07.2025.

Si rrjedhojë, e asaj që u theksua më sipër, Kolegji i Këshillit, bazuar në përshkrimin e detyrave të pozitës së punës së Udhëheqëses së Sektorit për Çështje Juridike dhe Administrative në Inspektoratin e Tregut, konstaton se ankuesja për punën e saj dhe çështjet administrative, raporton drejtpërdrejtë tek zyrtari/ja me titull dhe gradë të Kryeinspektorit të Tregut.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se zyrtarja znj.E.K, apo inicuesja e kësaj procedure disiplinore me numër protokolli I-1142/19 të datës 23.10.2025, përmes Vendimit me numër protokolli I-609/1 të datës 04.07.2025, të zv. Ministrit në detyrë të MINT, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin me numër protokolli I-1252/1 të datës 19.11.2025, **nga pozita e kategorisë profesionale, klasa profesional 1, atë të Inspektorese të Tregut**, të cilën e mbanë sipas Akt emërimit AE.Nr.38/2024 të datës 26.02.2024, **është emëruar në pozitën e kategorisë së lartë drejtuese, atë të Ushtrueses së Detyrës së Kryeinspektorese në Inspektoratin e Tregut.**

Ndërsa, referuar shkresave të lëndës Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, i cili ka nxjerrë Vendimin e kontestuar me ankesë, rrjedhë se është themeluar sipas Vendimit me numër protokolli I-309/02 të datës 10.04.2025, i ndryshuar me Vendimin me numër protokolli I-780/02 të datës 04.08.2025, mirëpo, se i njëjti është ndryshuar dhe plotësuar vetëm për shqyrtimin e kërkesës për incimin e procedurës disiplinore me numër protokolli I-1142/19 të datës 23.10.2025 ndaj ankueses, me Vendimin me numër protokolli I-1212/02 të datës 10.11.2025, të Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT- zyrtarit z. A.Xh, i cili **nga pozita e kategorisë së ulët drejtuese Udhëheqës në Laboratorin e Vëllimit Rrjedhës në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës**, të cilën e mbanë sipas Akt emërimit të datës 02.12.2019, fillimisht sipas Vendimit me numër protokolli 1481/15 të datës 12.08.2025, të Drejtoreshës Ekzekutive të AMK-së, **është emëruar Ushtrues i Detyrës i pozitës së kategorisë së mesme-Drejtorit të Drejtoratit të Metrologjisë Shkencore në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës**, dhe më tej nga mbajtja e kësaj pozite të mesme në cilësinë e ushtruesit të detyrës, i njëjti sipas Vendimit me numër protokolli I-806/01 të datës 13.08.2025, të zv. Ministrit në detyrë të MINT, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin me numër protokolli I-1249/01 të datës 19.11.2025, **është emëruar Ushtrues Detyre i Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, pozitë kjo e kategorisë së lartë drejtuese në shërbimin civil.**

Në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore, e duke marrë për bazë nenin 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Kolegji i Këshillit bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil ka analizuar aktin e kontestuar me ankesë në ndërlidhje me legjislacionin në fuqi që rregullon institutin e ushtruesit të detyrës, gjegjësisht nenin 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin përcaktohet se: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i*

kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit”, si dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: 1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari.

Tutje, Kolegji i Këshillit, konstaton se Kryeministri, me Vendimin Nr. 387/2022, të datës 29.09.2022, ka miratuar Rregulloren (ZKM) Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e cila ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në këtë ministri, ndërsa, me nenin 2, si agjenci ekzekutive në kuadër të MINT janë: *Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë; Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës; Agjencia e Pronësisë Industriale; Drejtorinë e Përgjithshme e Akreditimit; Agjencia e Metrologjisë së Kosovës; Agjencia Standardizimit të Kosovës dhe Inspektorati i Tregut* ku organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës i këtyre agjencive rregullohet me rregullore të veçantë, dhe se gjatë hulumtimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se në mbledhjen e 121 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin nr. 06/121 datë 27.03.2013, është miratuar Rregullore Nr.10/2013 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Inspektoratit të Tregut, e cila ka qenë në fuqi në periudhën kohore të ndërmarrjes së veprimeve për çështjen përkatëse, ku me të cilën rregullore struktura organizative e Inspektoratit të Tregut, përbëhet nga *Zyra e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, dhe Sektorët e Inspektoratit të Tregut të cilët janë: Sektori i Mbikëqyrjes Inspektuese në Prishtinë dhe Rrethinë; Sektori i Mbikëqyrjes Inspektuese në Mitrovicë dhe Rrethinë; Sektori i Mbikëqyrjes Inspektuese në Pejë dhe Rrethinë; Sektori i Mbikëqyrjes Inspektuese në Gjakovë dhe Rrethinë; Sektori i Mbikëqyrjes Inspektuese në Prizren dhe Rrethinë; Sektori i Mbikëqyrjes Inspektuese në Gjilan dhe Rrethinë; Sektori i Mbikëqyrjes Inspektuese në Ferizaj dhe Rrethinë; Sektori për Sigurinë e Produkteve; Sektori për Çështje Juridike, udhëheqëse e të cilit është ankuesja, si dhe Sektori për Punë të Përgjithshme. Ndërsa, sipas të dhënave nga web -faqja zyrtare e Inspektoratit të Tregut del se ky institucion funksionin sipas strukturës së organizimit: *Sektori për çështje juridike dhe administrative, Sektori për siguri të përgjithshme të produkteve, Sektori për mbikëqyrjen e tregut të naftës dhe Sektori i Tregut.**

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit me rastin e caktimit të nëpunëses së lartë theksuar në pozitën e Ushtrueses së Detyrës së Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita të aplikueshme ligjore që rregullojnë caktimin e ushtruesve të detyrës, ngase në rastin konkret është dashur të caktoj një zyrtar të lartë nga kategoria pasuese, apo mbi bazën e aktit normativ të theksuar si më lartë dhe strukturës organizative të publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni, thënë më konkretisht një zyrtarë që mbanë pozitën e kategorisë së ulët drejtuese me akt të konfirmuar, respektivisht Udhëheqës të Sektorëve, ndërsa në rastin konkret mbi dëshmitë e paraqitura dhe konstatimin e pasqyruar si më sipër rezulton se zyrtarja përkatëse nga pozita e kategorisë profesionale 1, është caktuar Ushtruese e Detyrës e pozitës së kategorisë së lartë drejtuese.

Ndërsa, në kuptim të statusit dhe organizimit të brendshëm të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës, Kolegji i Këshillit, i’u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L -037 për Metrologji, ku me nenin 5, është

përcaktuar se: 1. Agjencia e Metrologjisë së Kosovës është organ i vetëm i administratës shtetërore, përgjegjës për fushën e metrologjisë dhe aplikimin e saj në Republikën e Kosovës. 2. AMK është organ i pavarur i administratës shtetërore, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. 3. Struktura dhe organizimi i AMK-së, siguron paanshmëri dhe objektivitet në marrjen e vendimit për detyrat në metrologji. 4. AMK udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm. 5. Ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës do të zbatohet për themelimin, organizimin dhe funksionimin e AMK-së. 6. Organizimi dhe struktura e AMK-së, rregullohet përmes aktit nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.; dhe se kjo agjenci rezulton se përmes Vendimit Nr.619/2023, të datës 15.12.2023, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka të miratuar Rregulloren (ZKM) Nr.09/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës, e cila me nenin 4, paragrafin 1 strukturën organizative e cila është si vijon: 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv; 1.2. Departamentet; 1.3. Divizionet. 2. Numri i të punësuarve në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës është dyzet e një (41).; ndërsa, me nenin 6, është përcaktuar se: 1. Departamentet e Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës janë: 1.1. Departamenti i Metrologjisë Shkencore dhe Industriale i cili përbëhet nga divizionet: 1.1.1. Divizioni i Masës dhe Matjeve Dimensionale; 1.1.2. Divizioni i Forcës dhe Presionit; 1.1.3. Divizioni i Vëllimit dhe Rrjedhjes; 1.1.4. Divizioni i Madhësive Elektrike dhe Termometrisë. 1.2. Departamenti për Metrologji Ligjore përbëhet nga divizionet: 1.2.1. Divizioni i Madhësive Mekanike; 1.2.2. Divizioni i Madhësive Elektrike. 1.3. Divizioni i Punimeve nga Metalet e Çmuara; 1.4. Divizioni i Mbikëqyrjes Metrologjike.

Kolegji i Këshillit, duke i u referuar dispozitave të aplikueshme ligjore që rregullojnë caktimin e ushtruesve të detyrës sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, konstaton se ushtruesi i detyrës caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit, kurse në rrethanat e rastit konkret Ushtruesi i Detyrës i Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, si pozitë më e ulët apo vartëse nuk ka qenë duke e mbajtur me akt të konfirmuar, pra me akt të emërimit, gjegjësisht i njëjti sipas Akt emërimit të datës 02.12.2019 mban pozitën e kategorisë së ulët drejtues respektivisht Udhëheqës në Laboratorin e Vëllimit Rrjedhës në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, pozitë kjo e cila nuk është pozitë pasuese e Kategorisë së Lartë Drejtuese, sikurse e ka përcaktuar një gjë të tillë ligji material.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit me rastin e caktimit të nëpunësit përkatës në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita të aplikueshme ligjore që rregullojnë caktimin e ushtruesve të detyrës në shërbimin civil, ngase në rastin konkret është dashur të caktoj një zyrtar të lartë nga kategoria pasuese, apo thënë më konkretisht një zyrtarë që mbanë me Akt emërim pozitën e kategorisë së mesme drejtuese, nga Ministria e linjës së kësaj agjencie, ngase duke marrë parasysh se kjo ministri ka të rregulluar strukturën organizative me Rregulloren (ZKM) Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e me të cilën faktikisht nuk përcaktohet organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës për Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, përkatësisht do duhej të shfrytëzohen të gjitha mundësit e brendshme për arritjen e këtij qëllimi, detyrimisht do duhej që pozitën e lire të Sekretarit të Përgjithshëm, ta mbulonte me njërin nga zyrtarët publik që është me akt emërim në pozitën e Drejtorit të Departamentit brenda kësaj ministrie, e të cilët janë vartës të drejtpërdrejt

të kësaj pozite të kategorisë së lartë drejtuese, asaj të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, ndërsa faktikisht në rastin konkret janë anashkaluar këto pozita të nivelit të mesëm drejtues brenda MINT, rrjedhimisht është caktuar një nëpunës i kategorisë së ulët drejtuese nga AMK, jashtë strukturës organizative të kësaj ministrie.

Andaj, referuar konstatimeve si më sipër se caktimi në cilësinë e ushtruesve të detyrës së këtyre dy pozitave të kategorisë së lartë drejtuese, përkatësisht Zyrtarit Kryesor Administrativ në organin përkatës të punësimit dhe inicueses së kësaj procedurës disiplinore, është realizuar mbi shkelje të dispozitave përkatëse ligjore, gjegjësisht duke anashkaluar nëpunësit të cilët mbajnë pozitat e nivelit të mesëm drejtuese brenda kësaj ministrisë, e në rastin e caktimit të U.D Kryeinspektorit të Tregut, duke anashkaluar pozitat e ulëta drejtuese brenda kësaj Agjencie Ekzekutive, Kolegji i Këshillit, me qëllim të vërtetimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar me ankesën e datës 26.12.2025, mori për bazë dispozitat Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht: nenin 4, paragrafin 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj; si dhe nenin 52, ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit; dhe për rrjedhojë konstaton se Vendimi me numër protokolli 5380/02, i datës 27.12.2025, i Komisionit Disiplinor në MINT, përmes të cilit ankueses i është shqiptuar masa disiplinore “largim nga shërbimi civil”, është i pa ligjshëm në kuptim të nenit 4 dhe nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për faktin se inicuesja e kësaj procedure disiplinore dhe themeluesi i këtij organi, përkatësisht Komisionit Disiplinor, mbi bazën e konstatimeve të theksuara, përkatësisht vendimeve që janë objekt i kësaj ankese, rezulton se janë nxjerrë në mënyrë të kundërligjshme mbi arsyet e specifikuara më lartë, pasi që këta dy zyrtarë janë caktuar në mënyrë të kundërligjshme në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese, respektivisht atë të Ushtruesit të Detyrës së Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut dhe Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MINT.*

Prandaj, nisur nga konstatimet si më sipër se vendimi i Komisionit Disiplinor, si dhe aktet për caktimin e Ushtruesve të Detyrës së Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut Drejtorit Ekzekutiv dhe Sekretarit të Përgjithshëm në MINT, janë nxjerrë me shkelje ligjore, atëherë Kolegji i Këshillit, nuk ka trajtuar çështjet tjera të kësaj ankese për arsye se shkeljet ligjore janë evidentuar qysh në pikënisje të kësaj procedure, për faktin se çdo akt i nxjerr në kundërshtim me dispozitat materiale është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1, nen paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë sikurse përcaktohet me nenin 55 paragrafi 1 të LPPA-së, Kolegji i Këshillit vendosi që ta aprovoi si të bazuar ankesën e ankueses, të anuloi Vendimin me numër protokolli 5380/02, të datës 27.12.2025, të Komisionit Disiplinor në MINT, ndërsa të shfuqizoj Vendimin me numër protokolli I-806/01, të datës 13.08.2025, Vendimin me numër protokolli I-1249/01 të datës 19.11.2025, Vendimin me numër protokolli I-609/01, të datës 04.07.2025, si dhe Vendimin me numër protokolli I-

1252/01 të datës 19.11.2025, të Zëvendësministrit në detyrë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit, vendosi sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.2074/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, L.H;
- Ministres dhe Udhëheqëses së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MINT; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.